

## GJYKATA E QARKUT PRISHTINË

P Nr. 97/2001

16 dhjetor 2009

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut Prishtinë, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Angela Kaptain dhe gjyqtarja profesionale e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Zahide Gjonaj, si anëtarë të trupit gjykues, asistuar nga procesmbajtësja Nexhmije Mezini në çështjen penale kundër të akuzuarit **Besim Berisha aka Burim Dibrani**, i cili akuzohet për veprat penale Vrasje, në kundërshtim me nenin 30 paragrafin 2 artikullin 3 të Ligjit Penal të Kosovës, Heqje e paligjshme e lirisë në kundërshtim me nenin 63 paragrafin 4 siç lexohet me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë dhe Ekspozim ndaj rrezikut në kundërshtim me nenin 42 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Kosovës lexuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977), si në aktakuzën e Prokurorit Publik, parashtruar gjykatës më 22 nëntor 1999 dhe pastaj ndryshuar më 24 nëntor, 26 nëntor dhe 11 dhjetor 2009, që ishte më parë në paraburgim nga 3 gusht 1999 deri më 20 mars 2000, momentalisht në paraburgim që nga 27 gusht 2008 (kur është deportuar nga Franca),

pas një shqyrtimi gjyqësor publik të mbajtur më 28 korrik 2009, 5 gusht 2009, 31 gusht 2009, 7 shtator 2009, 7 tetor 2009, 19 tetor 2009, 10, 16 dhe 24 nëntor 2009, 8, 11, 15 dhe 16 dhjetor 2009, në praninë e Prokurores Publike znj. Laura Pula dhe Prokurorit të EULEX Paul Scoggin, të akuzuari dhe Avokatëve të tij mbrojtës Ymer Osaj dhe Mexhid Sylja, shpall publikisht më 16 dhjetor 2009 si në vijim:

### AKTGJYKIM

I pandehuri **Besim Berisha aka Burim Dibrani** i lindur më 1 shkurt 1980, i biri i Ejupit dhe Mihrijes me mbiemër vajzërie Kastrati, i lindur në Prishtinë, vendbanimi i tij i mëparshëm në rrugën "19 Nëntori" nr.21/6, Prishtinë, ka përfunduar vitin e parë të shkollës së mesme, i pamartuar, i papunësuar, shqiptar nga Kosova,

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më 2 gusht 1999 rreth orës 20.45, i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani ka hyrë në mënyrë të paligjshme, me qëllim të mbledhjes së armëve, me persona tjerë të panjohur, në shtëpinë e Momčilo Milenković-it, që ndodhet në rrugën "Gjurgjevdanska" nr. 138 në Prishtinë, e ka vendosur atë në një gjendje në të cilën i është kërcënuar jeta duke e sulmuar, rrahur dhe duke i lidhur qafën me mbulesën e tavolinës dhe me këto akte e ka bërë atë të

pafuqishëm dhe pastaj e ka braktisur atë. Momčilo Milenković, i ekspozuar ndaj kësaj rrethane të rrezikshme si pasojë vdes të njëjtën ditë.

Ai në këtë mënyrë ka kryer veprën penale

**Ekspozim ndaj rrezikut në kundërshtim me nenin 42 paragrafin 2 të Ligjit Penal të Kosovës lexuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977).**

Sipas nenit 350 paragrafit 3 të Ligjit mbi Procedurën Penale (Gazeta Zyrtare Nr. 26/86) i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani lirohet nga veprat penale:

Vrasje nga neni 30 paragrafi 2 artikulli 3 i Kodit Penal të Kosovës dhe

Heqje e paligjshme e lirisë, neni 63 paragrafi 4 siç lexohet me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë.

Pasi që nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprat me të cilat ai ngarkohet.

Ai në këtë mënyrë

## **DËNOHET**

Në pajtim me nenin 42 paragrafin 2 të Ligjit Penal të Kosovës lexuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977) **me gjashtë (6) vjet burgim.**

Në pajtim me nenin 351 paragrafin 6 të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP) dhe nenin 50 paragrafin 1 të Kodit Penal të RSFJ-së (KPJ), koha që ka kaluar në paraburgim Besim Berisha aka Burim Dibrani, nga 3 gusht 1999 deri më 20 mars 2000 dhe nga 27 gusht 2008 (kur është deportuar nga Franca) deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit do të përfshihet në lartësinë e dënimit.

## **SHPENZIMET**

Në pajtim me nenin 98 paragrafin 1 të LPP-së, ai duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej dyqind (200) Eurove për veprën penale ekspozim ndaj rrezikut.

## **ARSYETIM**

### **I. Historiku procedural**

Më 22 nëntor 1999 Prokurori publik ngriti një aktakuzë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurit Besim Berisha për veprat penale Vrasje nga neni 30 paragrafi

2 artikulli 3 i Kodit Penal të Kosovës dhe Heqje të paligjshme të lirisë, neni 63 paragrafi 4 siç lexohet së bashku me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë. Kjo aktakuzë është ndryshuar më pastaj më 24 nëntor 2009, 26 nëntor 2009 dhe 11 dhjetor 2009 për të përfshirë veprën penale Ekspozim ndaj rrezikut në kundërshtim me nenin 42 paragrafin 2 të Ligjit Penal të Kosovës lexuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977). Më 11 dhjetor 2009 prokurori publik i EULEX-it e ka ndryshuar gojarisht aktakuzën për të paraqitur se data e arrestimit është 3 gusht 1999 dhe jo 2 gusht 1999, siç paraqitet në vendimet e gjykatës të lëshuara në atë kohë, të cilat gjenden në dosjen e rastit.

Shqyrtimi gjyqësor i mëparshëm (i pari) ka filluar më 20 mars 2000 para panelit të përbërë prej pesë (5) gjyqtarëve me kryetarin e trupit gjykues Zef Prenaj. Të njëjtën ditë është shpallur aktgjykimi nga trupi gjykues. I pandehuri është liruar nga veprat penale siç është akuzuar në aktakuzë dhe paraburgimi i tij është ndërprerë. Më 23 shkurt 2000 kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një vendim për të ndarë dokumentet e KFOR-it Pejë dhe kasetat VHS nga dosja e rastit në pajtim me nenet 83 dhe 84 të LPP-së.

Më 17 prill 2001 Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur mbi ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut, ka vendosur që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P Nr 77/1999 të anulohet dhe rasti t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Më 3 korrik 2001 rigjykimi (P Nr 97/2001) filloi para trupit gjykues të përbërë prej pesë (5) gjyqtarëve me Zef Prenaj si kryetar të trupit gjykues dhe ka vazhduar më 10 shtator 2001. Të njëjtën ditë trupi gjykues lëshon një vendim se shqyrtimi gjyqësor do të shtyhet për një kohë të pacaktuar, derisa të sigurohej prania e të pandehurit Besim Berisha, nga Policia e UNMIK-ut dhe deri sa të dihej vendndodhja e palëve të dëmtuara.

Më 7 nëntor 2002 kryetari i trupit gjykues, Raif Emmini, lëshoi një urdhër arrest kundër të pandehurit. Më 24 dhjetor 2004 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut lëshoi një letërreshtim kundër të pandehurit.

Më 27 gusht 2008 i pandehuri është deportuar nga Franca dhe është mbajtur në paraburgim nga Policia e UNMIK-ut.

Më 12 maj 2009 zëvendës-Presidenti i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, ka lëshuar një vendim me anë të të cilit i cakton këtë rast gjyqtarëve të EULEX-it pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në bazë një kërkesë me shkrim të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Anton Nokaj, më datën 17 prill 2009.

Rigjykimi ka filluar më 28 korrik 2009 para trupit gjykues të ri të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Arkadiusz Sedek, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it, Angela Kaptain dhe gjyqtarja profesionale e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Zahide Gjonaj, si anëtarë të trupit gjykues.

Rigjykimi ka vazhduar më 5 gusht 2009, 31 gusht 2009, 7 shtator 2009, 7 tetor 2009, 19 tetor 2009, 10, 16 dhe 24 nëntor 2009, 8, 11, 15 dhe 16 dhjetor 2009.

Më 28 korrik 2009 trupi gjykues ka dëgjuar dëshminë e dëshmitares- palës së dëmtuar **Valentina Alsentijević** dhe palës së dëmtuar **Budimir Milenković**. Gjykata ka mësuar se dëshmitarja- pala e dëmtuar **Jorgovanka Milenković**, ka vdekur më 5 shkurt 2002, certifika e vdekjes së Jorgovanka Milenkovićit, i është siguruar trupit gjykues nga anëtarët e familjes.

Më 5 gusht 2009 trupi gjykues ka dëgjuar dëshminë e dëshmitarit **Enver Kastrati**.

Më 31 gusht 2009 trupi gjykues ka lajmëruar se do të thirren ekspertët mjekësor për të dëshmuar lidhur me shkakun e vdekjes së viktimës Momčilo Milenković dhe gjendjen fizike të të pandehurit.

Më 7 shtator 2009 trupi gjykues ka dëgjuar ekspertin mjekësor Dr Marek Gasior. Trupi gjykues ka caktuar ekspertët mjekësor **Dr Marek Gasior** dhe **Tefik Gashin**.

Më 16 shtator 2009 kryetari i trupit gjykues mori pjesë në zhvarrimin e mbetjeve mortore të Momčilo Milenkovićit në varrezat e Prishtinës.

Më 7 tetor 2009 trupi gjykues kishte planifikuar të dëgjojë dëshminë e **Dr Jusuf Ulaj**, dëshmitari nuk është paraqitur para gjykatës.

Më 19 tetor 2009 trupi gjykues dëgjoji dëshminë e **Dr Jusuf Ulaj**.

Më 10 nëntor 2009 trupi gjykues dëgjoji dëshminë e **Dr Bedri Bakallit**.

Më 16 nëntor 2009 trupi gjykues dëgjoji dëshminë e **Dr Marek Gasior** dhe **Dr Tefik Gashit**.

Më 24 nëntor 2009 trupi gjykues dëgjoji dëshminë e **Dr Blerim Qosaj**.

Më 8 dhjetor 2009 trupi gjykues dëgjoji dëshminë e **Oficerit Gianluca Basso** (përmes video konferencës).

Më 11 dhjetor 2009 trupi gjykues ka pranuar si dëshmi dokumentet në vijim dhe ka dëgjuar fjalën përfundimtare të prokurorit publik.

1. Ekspertizën mjekësore të Dr Tefik Gashit dhe Dr Marek Gasior
  - a. Raportin e autopsisë MA 09 252, të datës 11 tetor 2009,
  - b. Raportin e ekzaminimit fizik MP 09-056, të datës 17 tetor 2009,
  - c. Mendimin e mjekësisë ligjore për rastin numër P Nr 97/01 (MP 09-056, MA 09-252), të datës (version i shkruar me dorë në gjuhën angleze) 29 tetor 2009.
2. Vërtetim pronësor i njësitit special hetues (me numrin referues 87679/99 dhe 149/99) të datës 30/08/99 nënshkruar nga Keshri Lan? (i shkruar me dorë) nga njësia SIU
3. Letra e KFOR-it dhe lista e certifikuar e paraburgimit (numri referues 0610/DOS KV101/09) më datën 9 dhjetor 2009 nga M Scholze dhe Istvan Kokics (version në gjuhën angleze 4 faqe)
4. Letër dhe dokumentet e bashkëngjitura nga Ministria e Punëve të Brendshme (nga Blerim Camaj) më datën 27 tetor 2009, kërkesa e emëruar "Regjistrimi civil dhe i votuesve" më datën 15/07/2000, fotografia e skanuar dhe e zmadhuar, shenjat e gishtave (2) dhe certifikata origjinale e lindjes,

5. Letër dhe dokumentet e bashkëngjitura nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, më datën 21 tetor 2009 (nga Prof. Ass Faton Morina), fotokopja e librit të administartës për datën 6 korrik 1999,
6. Të dhënat mjekësore të të ndjerit Momcilo Milenkovic nga Arkivi Shtetëror i Kosovës (2 faqe),
7. Fletëlëshimin për kriza epilepsie me numër 1354 në lidhje me Burim Dibranin nënshkruar nga Dr B Qosaj,
8. Letër e KFOR-it të datës 7 dhjetor 2009 me numrin referues 0610/LEG KV 103/09 nga HIRSCH Christian,
9. Letër nga Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (EULEX Kosovë) Alan Robinson më datën 7 shtator 2009 me numrin referues JC/OMPF/09/AR/049
10. Letër dhe dokumente të bashkëngjitura (të vërtetuara si kopje të origjinalit, 3 faqe) nga Bajram Zymberi më datën 20 gusht 2009 me numër reference 0973/09, domethënë Vërtetim Arrestimi dhe Paraburgimi, Të dhënat e sektorit për të paraburgosur dhe denimi dhe kopja e fotografisë shënuar P 443/99 Berisha, Besim më datën 2/11/1999,
11. Letër përcjellëse nga PP Paul Scoggin dhe 5 (pesë) fotografi të printuara me ngjyrë (nga CDROM) shënuar A, B, C, D, E.
12. Certifikata e vdekjes së Jorgovanka Milenkovicit me numër referues 367/112, me datën dhe kohën e vdekjes: 5 shkurt 2002 në ora 15:15.
13. Kaseta VHS e skenës së krimit
14. Deklaratat e dëshmitarëve në vijim:
  - a. Z. Budimir Milenkovic, dëgjuar më 28 korrik 2009
  - b. Znj. Valentina Aksentijevic, dëgjuar më 28 korrik 2009
  - c. Z. Bedri Bakalli, dëgjuar më 10 nëntor 2009
  - d. Z. Jusuf Ulaj, dëgjuar më 19 tetor 2009
  - e. Z. Blerim Qosaj, dëgjuar më 24 nëntor 2009
  - f. Z. Gianluca Basso, dëgjuar më 8 dhjetor 2009
  - g. Z. Avdyl Dibrani, dëgjuar më 11 dhjetor 2009
  - h. Z. Enver Kastrati, dëgjuar më 5 gusht 2009
  - i. Znj. Jorgovanka Milenkovic, lexuar më 11 dhjetor 2009,
15. Raporti nga eksperti i shenjave të gishtave nga Kevin J Miller, rreshter i Policisë së Kalorësisë Mbretërore Kanadeze, me shenjat e gishtave të bashkëngjitur,
16. Letër nga KFOR-i me numër referues nr Agricola/legal/318 më datën 8 maj 2000,
17. Letër nga "Qendra Klinike Universitare, Instituti i Mjekësisë Ligjore" më datën 27 korrik 2009.

#### **Lista e mbrojtjes:**

1. Kërkesa për fillimin e hetimeve PP. nr. 146/99, më datën 13 gusht 1999,
2. Vendimi mbi fillimin e hetimeve dhe Vlerësimi i Paraburgimit Nr 96/99, më datën 27 gusht 1999,
3. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë mbi Vazhdimin e Paraburgimit, Nr 80/99, më datën 31 gusht 1999,
4. Procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor P. Nr. 77/99, më datën 20 mars 2000,
5. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë lidhur me ndarjen e dokumenteve të rastit të KFOR-it, P. Nr. 77/99, më datën 23 shkurt 2000,
6. Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit Avdyl Dibrani, Nr 96/99, më datën 31 gusht 1999,

7. Procesverbali i marrjes në pyetje para Gjyqtarit Hetues, të dëshmitarit Enver Kastrati, Nr 96/99, më datës 14 tetor 1999.

### **Lista e prokurorisë:**

1. “Raporti fillestar i rastit” më datën 08.05.1999 nga EJ Woolbridge,
2. Deklarata fillestare e Besim Berishës, më datën 08.08.1999, dhënë rreshterëve, Roberts dhe Float,
3. Deklarata fillestare of Enver Kastrati, më datën 05.08.1999, dhënë rreshterëve, Roberts dhe Float,
4. Deklarata fillestare of Avdyl Dibranit, më datën 05.08.1999, dhënë rreshterëve, Roberts dhe Float,
5. Deklarata fillestare of Jorgovanka Milenković më datën 03.08.1999, dhënë rreshterit Roberts,
6. Deklarata e Jorgovanka Milenković më datën 04.08.1999,
7. Deklarata fillestare e Valentina Milenkovic më datën 03.08.1999, dhënë rreshterit Float dhe nënshkruar nga Miljana Ristic,
8. Deklarata e Brendan Tanslen më datën 03.08.1999,
9. Letra e 17.05.2000, duke vërtetuar dhe autorizuar lëshimin e 19 faqeve të raporteve nga Kapit. Paola Nardelli,
10. Pesë faqe të formularëve të arrestimit për Dibrani, Kastrati, Berisha, Sahit and Hajdari (të shënuara “Modulo Identificazione” në italisht),
11. Deklaratë e detyrave të kryera më 3 gusht, 1999 nga WO Gianluca Basso (dy faqe, anglisht dhe shqip),
12. Deklaratë e paraburgimit të përkohshëm më 3 gusht, 1999 nga WO Gianluca Basso (tri faqe, anglisht, italisht dhe shqip),
13. Deklarata e Avdyl Dibranit e datës 03.08.1999 në ora 10.20, dhënë WO Angelo Mini dhe Vincenzo Gullotto (tri faqe italisht, shqip dhe anglisht),
14. Deklarata e Hajdar Sahitit më datën 03.08.1999 në ora 10.30, dhënë WO Angelo Mini dhe Vincenzo Gullotto (tri faqe italisht, shqip dhe anglisht),
15. Deklarata e Enver Kastratit më datën 03.08.1999 në ora 10.35, dhënë Vincenzo Gullotto (tri faqe italisht, shqip dhe anglisht),
16. Deklarata e Besim Hajdari më datën 03.08.1999, në ora 11.35, dhënë Vincenzo Gullotto (tri faqe italisht, shqip dhe anglisht),
17. Vërtetimi i regjistrimit të burgut dhe letra kthyesë më datën 04.05.1999 nga Vittorio De Stasio dhe Emilio Della Sala (tri faqe, italisht, shqip dhe anglisht),
18. Autorizimi i veturës, dhënë Zeqir Braimit, (katër faqe italisht, shqip, anglisht dhe serbisht),
19. Dokument faturë më datën 06.08.1999 nga Besim Hajdari (e shënuar faqja 15 e përkthimit) (tri faqe, italisht, anglisht dhe shqip),
20. Raporti mbi personat e pagjetur, më datën 04.05.2000 nga Vittorio De Stasio (e shënuar faqja 16 e përkthimit) (tri faqe, italisht, anglisht dhe shqip),
21. Vërtetim i fletëshënimit të burgut dhe letra kthyesë; nga Vittorio De stasio (e shënuar faqja 17 e përkthimit) (tri faqe, italisht, anglisht dhe shqip),
22. Regjistri i burgut, më datën 04.08.1999 (tri faqe, italisht, anglisht dhe shqip),
23. Procesverbali i shqyrtimit të parë gjyqësor (gykimin fillestar),
24. Deklarata e ZPPML në lidhje me statusin e Svetomir Milenkovicit,
25. Të dhënat mjekësore nga KFOR-i italian lidhur me të pandehurin nga viti 1999.

26. Letra përcjellëse e datës 16.05.2000 nga Xhevat Halili, bashkëngjitur ankesës për këtë çështje (dy faqe, anglisht dhe shqip),

27. Certifikata e ankesës nga Kapiteni Cook, më datën 08.05.2000.

Më 15 dhjetor 2009 trupi gjykues ka dëgjuar fjalën përfundimtare të mbrojtjes.

Më 16 dhjetor 2009 trupi gjykues shpalli aktgjykimin.

### **I: Gjetjet faktike:**

Momčilo Milenković, i moshës 64 vjeçare, në vitin 1999, ka jetuar së bashku me familjen e tij në Prishtinë, në rrugën Gjurgjevdanska, numër 138. Anëtarët e familjes së tij ishin si në vijim: vajza e tij Jorgovanka Milenković, djali i tij Svetomir Milenković dhe mbesa e tij Valentina Aksentijević.

Në ditën e hënë më 2 gusht 1999 në ora 18.00, dikush ka trokitur në derë, Jorgovanka nuk e ka hapur derën, por ajo dëgjoi bisedën në gjuhën serbe në mes të një burri dhe babait të saj. Në këtë kohë nuk ka mundur të identifikohet numri dhe identiteti i personave që kanë hyrë me forcë. Njëri nga këta burra i thotë Momčilo Milenkovićit ta lëshojë shtëpinë deri në ora 20.00. Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë Momčilo Milenković, përgjigjet se nuk ka ku të shkojë dhe te kush të shkojë. Ky burrë i tha se do të vijnë më vonë. Familja e Milenkovićit vendosi që të mos lëshojnë shtëpinë, duke shpresuar se personat që kanë hyrë me forcë nuk do të shfaqeshin sërish.

Në ora 20.45, siç ishte premtuar, ata u kthyen dhe filluan të trokasin në derë, ata kërkuan që të hapej dera ose për ndryshe ata do ta hapnin derën me forcë. Pasi që familja Milenković nuk kanë dashur të hapin derën vullnetarisht, katër burra u futën me dhunë, në mes tyre, gjithashtu i pandehuri Besim Berisha.

Jorgovanka Milenković dhe Valentina Aksentijević ishin ndarë në njërin nga dhomat, ndërsa i pandehuri e ka kapur Momčilo Milenkovićin për kraharori dhe e ka çuar në kuzhinë. Besim Berisha ka kërkuar nga Momčilo Milenkovići ti tregoj vendin se ku e mbante ai revolen dhe pushkën. Besim Berisha e ka thirrur personin tjetër që ka hyrë me forcë që të shkonte në kuzhinë, identifikuar dhe përshkruar nga Jorgovanka Milenković në deklaratën e saj, si burri i dytë. Momčilo Milenković ishte rrahur dhe qafa i ishte lidhur me mbulesën e tavolinës nga Besim Berisha dhe një burrë tjetër.

Jorgovanka Milenković dhe Valentina Aksentijević kanë qëndruar në njërin nga dhomat duke u ruajtur nga njëri prej sulmuesve, identifikuar si burri i tretë nga Jorgovanka Milenković.

Burrat që përshkruhen nga Jorgovanka Milenković si burri i dytë, i tretë dhe i katërt kanë kontrolluar shtëpinë duke kërkuar për para dhe ari.

Jorgovanka Milenković dhe Valentina Aksentijević kanë lëshuar dhomën dhe kanë shkuar në terasë së bashku me personat që kanë hyrë me forcë, por burri i parë dhe i dytë i kanë urdhëruar atyre që të hyjnë brenda dhe të mos bërtasin.

Personat që kanë hyrë me forcë, kanë gjetur para në shumë prej 2700 dinarëve, televizorin dhe stoli ari të cilat i morën me vete.

Pastaj Jorgovanka Milenković e gjeti babain e saj në kuzhinë, ai e kishte qafën e lidhur me mbulesën e tavolinës. Kur Jorgovanka Milenković e zgjidhi mbulesën e tavolinës, atij filloi t'i rridhte gjak nga hunda dhe goja. Momçilo Milenković ishte mbështetur për lavaman dhe papritmas ai ra përtokë duke gjakderdhur shumë.

Pas kësaj Jorgovanka Milenković vrapoi në një shtëpi të vjetër të shihte nëse vëllai i saj ishte atje, por ajo nuk mundi ta gjente atë. Ajo u kthye në shtëpi duke e thirrur atë, por kot. Gjatë këtij incidenti Svetomir Milenković ishte fshehur. Nuk është vërtetuar sigurt nëse ai kishte ikur apo ishte kidnapuar nga sulmuesit. Sulmuesit ikën nga shtëpia rreth orës 22.00.

Jorgovanka Milenković atëherë thirri për ndihmë dhe KFOR-i u paraqit atje. Trupi i Momçilo Milenković-it u gjend në skenën e krimit, u regjistrua me kamerë nga KFOR-i. Trupi u dërgua në morgun e Spitalit të Universitetit në Prishtinë. Nuk është bërë autopsia dhe trupi i të ndjerit iu dorëzua familjes për ta varrosur. Të njëjtën ditë Jorgovanka Milenković, u mor në pyetje dhe i ofroi KFOR-it detajet e incidentit së bashku me të dhënat e detajuara të sulmuesve.

Të nesërmen, më 3 gusht 1999, në mëngjes rreth orës 9.00, pesë (5) burra shqiptarë janë kapur nga KFOR-i Italian në Deçan, në afërsi të Pejës - 80 km në perëndim të Prishtinës, pasi që disa prej tyre i janë përshtatur përshkrimit të ofruar nga Jorgovanka Milenković. Këta meshkuj ishin identifikuar si Hajdar Sahiti, Besim Hajdari, Avdyl Dibrani, Enver Kastrati dhe Besim Berisha. Shenjat e gishtave dhe fotografitë e personave të kapur, janë marrë nga hetuesit. Më 4 gusht 1999, kur është organizuar defilimi i identifikimit, Jorgovanka Milenković është dërguar në stacionin policor në Pejë. Gjatë defilimit të identifikimit pesë (5) burrat shqiptarë iu prezantuan asaj. Jorgovanka Milenković e njohu burrin, me emrin Besim Berisha, si personin që ka hyrë në shtëpinë e tyre më 2 gusht 1999 dhe të cilin ajo e përshkroi si burrin e parë.

Besim Berisha kishte përdorur një emër të rrejshëm gjatë identifikimit të tij, sipas dokumenteve nga Ministria e Punëve të Brendshme, emri i tij i vërtetë është **Burim Dibrani**.

Gjatë kohës kur është kryer krimi, për shkak të lëndimeve, dora e majtë e Besim Berishës ishte në allçi dhe këtë fakt e ka mbajtur në mend Jorgovanka Milenković. Më vonë gjatë hetimit, ajo e përdori këtë tipar dallues si një nga faktorët për të identifikuar të pandehurin si një nga sulmuesit, të cilët e kanë rrahur babin e saj.

Sipas të dhënave mjekësore, Momçilo Milenković ka vuajtur nga sëmundja e zemrës dhe ishte hospitalizuar në të kaluarën. Kjo është elaboruar në ekspertizën e Dr Gasior dhe Dr Gashit, MA 09-056 MA09 252 më datën 29 tetor 2009. Për shkak të faktit se nuk është kryer

autopsia, nuk ka qenë e mundur të caktohet rrjedha e drejtpërdrejtë e vdekjes së Momčilo Milenkovićit. Dëshmitari ekspert prezantoi të gjeturat, në bazë të të cilave arsyeja më e mundshme e këtij incidenti tragjik ishte aritmia e zemrës ose pushim kardio respiratoral lidhur me stres, përpjekje dhe kufizim pozite. Pasi që asnjë dëshmi, madje as rrethanore, nuk është paraqitur që të përcaktojë se Besim Berisha ka vepruar me qëllim të privimit të jetës së Momčilo Milenkovićit, fakti se i vdekuri ishte rrahur nga Besim Berisha dhe pastaj është lënë pa i ofruar kurrfarë ndihme duhet të konsiderohet si lënie e tij në rrethana kërcënuese për jetën, të shkaktuara nga vet Besim Berisha. Është e qartë se vdekja e Momčilo Milenkovićit është rezultat i veprimeve të lartpërmendura.

## II: Vlerësimi i provave:

Faktet e vërtetuara në këtë aktgjykim bazohen në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në procesin e rikrijimit të qëllimit të të pandehurit dhe vërtetimit se kush është fajtor për krimet e pretenduara, njëra nga provat më të rëndësishme janë deklaratat e dhëna nga dëshmitaret okulare, Jorgovanka Milenković dhe Valentina Alsentijević.

Jorgovanka Milenković është marrë në pyetje më 3 gusht 1999, nga Rreshteri Roberts, pasi që është informuar se deklaratat mund të përdoren si dëshmi dhe dëshmia e rrejtshme përbën vepër penale. Dëshmitarja ka konfirmuar gjithashtu se deklarata e dhënë është e vërtetë sipas dijenisë dhe besimit të saj më të mirë.

Jorgovanka Milenković në kohën e krimit të pretenduar ishte vajza e Momčilo Milenkovićit dhe motra e Svetislav Milenkovićit. Ajo ka dhënë një përshkrim të detajuar dhe në hollësi të situatës, e cila ka çuar tek vdekja e babait të saj. Sipas deklaratës së saj: *“Dje, të hënën më 2 gusht 1999, në ora 18.00, dikush erdhi dhe trokëti në derën e hyrjes e cila ishte e mbyllur. Unë nuk i pashë ata, (...) e dëgjova vetëm njërin prej tyre të fliste. Ishte zë mashkull që fliste në gjuhën serbe. Gjithë çka dëgjova ishte se ne duhej ta lëshonim shtëpinë deri në ora 20.00. Më vonë dëgjova babain tim të thoshte se nuk kemi ku të shkojmë dhe se nuk kemi askënd se të kush të shkojmë. Ai njeri tha se ata do të kthehen më vonë (...). Pastaj babai erdhi dhe bisedoi me ne. Ai na tha se dikush na kërcënonte dhe pyeti se çfarë do të bëjmë. Unë dhe vëllai im i thamë se ne do të mbesim këtu; ndoshta ata nuk do të na bëjnë gjë. Ata erdhën përsëri rreth orës 20:45 dhe filluan të trokasën në derë. Ata kërkuan që të e hapim derën vullnetsbëm ose me forcë. I kam dëgjuar përmes derës dy zëra duke biseduar. Babai iu tha atyre se nuk do ta hapte derën. Ata thanë: “Plaku Momo hape derën ose do ta thejmë”. Më vonë katër nga ata e kanë hapur derën me forcë.”*

Pastaj Jorgovanka Milenković dha një përshkrim të detajuar të katër personave që kanë hyrë me forcë. Nga qëndrimi i gjykatës, është e qartë se kjo dëshmitare kishte një mjedis të shkëlqyer për t’i parë mirë të gjithë sulmuesit, pasi që ajo ishte në terasë tërë kohën dhe është një e ditur e logjikshme se dielli perëndon shumë vonë në gusht. Është e rëndësishme të theksohen detajet në vijim, siç është përshkrimi i njërit nga burrat e përmendur. Dëshmitarja thotë se: *“Njeriu i parë, rreth 30 vjeç, me gjatësi mesatare, rreth 1.70m., i shkurtër, me flokë ngjyrë kafe, me bark të madh. Ai kishte këmbë me vija të bardha dhe të kaltëra, xbinsa të zeza dhe atlete të zeza. Ky njeri kishte allçi në krabun e djathtë, sa më dukej mua. Katër gishtërinj i kishte të mbështjellur me allçi, ndërsa gisht i madh ishte me allçi tjetër. Ai e kishte allçinë deri në mes të krabut. Allçia ishte shumë e bardhë dhe e pastër”*. Përshkrimi i katër personave që kanë hyrë me forcë dhënë nga kjo dëshmitare ishte aq i saktë që bazuar në këtë dëshmi, të nesërmen KFOR-i i kapi 5 burrat.

Besueshmëria e kësaj deklarate për sa i përket faktit se i pandehuri e kishte dorën e futur në allçi është konfirmuar nga dëshmi tjera mbështetëse të cilat do të vlerësohen më poshtë.

Sipas deklaratës së Jorgovanka Milenkovićit, kanë ndodhur ngjarjet në vijim: ” *I pari dhe i dyti urdhëruan dërgimin tim dhe të vajzës në dhomën time. I pari e ka kapur babain tim krabarori dhe tha: “Ndalu. Hyr Brenda dhe më trego se ku janë revolet dhe pushka” I pari hyri në kuzhinë me babain tim. Unë e pashë atë.(...) Pastaj i dyti shkoi në kuzhinë, sepse i pari e thirri atë. I treti mori urdhërin të rrinte me mua dhe vajzën time. Ai e mbylli derën e dhomës ku ishim sepse vajza ime filloi të qaj dhe të bërtas. (...) . Burri i dytë, i tretë dhe i katërt erdhën në dhomën time dhe të vëllait dhe kontrolluan gjithçka, ata nxorën dhe thyen çdo gjë. Pastaj ata gjetën të holla dhe ari në dhomën time. Burri i dytë gjeti të holla dhe ari. I lutesha atij të më linte ca të holla për fëmijën. Ai më kapi për mjekër dhe më tha :”Do të jap të hollat po qe se më jep revolen”.(…). Pastaj unë hyra në kuzhinë me vajzën time. Ata kishin lidhur qafën e tij ( të babait të saj) me mbulesë të tavolinës me qëllim që ta mbysin, pastaj unë shkova dhe ai kërkoi që ta zgjidhnim. Ai kishte provuar vet, edhe unë gjithashtu por kur e zgjidhëm vetëm pak, filloi t’ i rrjedhë gjak nga hunda dhe goja. Ai u përku në lavaman dhe papritur u rrëzua duke i rrjedhur shumë gjak. “*

Rrjedha e ngjarjeve të sipër përmendura të paraqitura nga dëshmitarja Jorgovanka Milenković është e qartë dhe logjike. Dëshmitarja ka bërë një deklaratë faktike me plot detaje, bazuar në njohurinë e saj të ngjarjes që ka ndodhur. Deklarata e Jorgovanka Milenkovićit nuk është gjetur e besueshme duke iu referuar vetëm njëres pikë, kur ajo ka deklaruar:” *Ata kishin lidhur qafën e tij ( të babait të saj) me mbulesë të tavolinës me qëllim që ta mbysin*”. Rregulla e dëshmitarit në procedurën penale është të japë një shpjegim të plotë dhe të saktë të asaj çfarë ka parë, e jo të bëjë vlerësime pasi që ky është obligim ligjor i panelit.

Përveç paraqitjes së rrjedhës së ngjarjeve, dëshmitarja Jorgovanka Milenković, e ka njohur të pandehurin Besim Berisha aka Burim Dibrani si burrin, të cilin e ka përshkruar si të dyshuarin Nr.1, në deklaratën e dhënë më 03 gusht 1999, me allçi në krah.

Deklaratat e dhëna nga Jorgovanka Milenković gjatë hetimit janë të një rëndësie themelore për rastin, pasi që ajo ishte dëshmitarja kryesore për sa i përket historisë së krimit dhe ajo e ka identifikuar të pandehurin. Paneli nuk ka kurrfarë dyshimi për sa i përket besueshmërisë së kësaj dëshmitareje dhe vërtetësisë së deklaratës së saj. Duke i vlerësuar këto deklarata është e kuptueshme se ato janë të qëndrueshme dhe logjike. Është e qartë se kur Jorgovanka Milenković i ka bërë këto deklarata, menjëherë pas shfaqjes së ngjarjeve kritike; ajo ka qenë në gjendje t’i ofrojë KFOR-it të gjitha detajet e mundshme.

Fatkeqësisht trupi gjykues nuk ka patur rastin ta merr në pyetje Jorgovanka Milenkovićin, pasi që ajo vdiq më 5 shkurt 2002 në ora 15:15, dhe si rrjedhojë deklaratat e saja të mëparshme janë lexuar me vendim të trupit gjykues dhënë në pajtim me nenin 333 paragrafin1 pikën 1 të Ligjit mbi Procedurën Penale (Gazeta Zyrtare Nr.26.86). Duhet të theksohet se paneli ka pasur baza të mjaftueshme ligjore për të pranuar si dëshmi, deklaratat e dhëna nga Jorgovanka Milenković, gjatë hetimit, ku sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/17 mbi pranueshmërinë e deklaratave të caktuara të dëshmitarëve gjatë hetimeve paraprahe, paragrafi 1 thotë: ” *Deklarata e dëshmitarit e bërë me shkrim nga një zyrtar në shërbim të autoriteteve relevante të zbatimit të ligjit, gjatë hetimeve të tij apo saj, dubet të jetë e pranueshme në hetimet fillestare. Kjo dispozitë zbatohet vetëm kur i njëjti dëshmitar nuk është marrë në pyetje akoma nga gjyqtari i hetimit dhe nuk mund të merret në pyetje nga gjyqtari hetues pasi që ai apo ajo është i/ e papranueshëm/ e për autoritetet relevante, madje edhe pasi që të jenë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të gjetur atë”.*

Jorgovanka Milenković është marrë në pyetje nga autoritetet relevante për zbatimin e ligjit – oficeri britanez rreshteri Roberts, që ka shërbyer në policinë ushtarake të KFOR-it (shih paragrafin 2 të ligjit të mësipërm) dhe megjithëse janë bërë tentime shtesë për të gjetur dhe marrë në pyetje atë, fatkeqësisht Jorgovanka Milenković, nuk është gjetur (shih letrën e datës 15 shtator 1999 nënshkruar nga kapiteni PJ Davies, drejtuar gjyqtarit Ramë Gashi). Hetimi mbi këtë rast është filluar më 27 gusht 1999, që do të thotë pas afatit të vendosur në paragrafin 4 të rregullores së përmendur më parë, që do të thotë se janë shikuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga ligji relevant, për të përdorur deklaratën e Jorgovanka Milenkovićit.

Si shtesë deklarata e Jorgovanka Milenkovićit vërtetohet plotësisht nga deklarata e dëshmitares tjetër, Valentina Alsentijević. Valentina Alsentijević ishte tetë (8) vjeçare kur kanë ndodhur ngjarjet. Në deklaratën e dhënë para rreshterëve Peters- Float, dëshmitarja ka deklaruar se më 2 gusht 1999, katër (4) të rinj erdhën në derën e tyre dhe i urdhëruan ata të lëshonin shtëpinë, pastaj ata u kthyen: *”duke kërkuar pushkë automatike dhe revole, duke na kërcënuar se do të na vrasin nëse nuk i dorëzojmë ato”*. Pas kësaj Valentina Alsentijević ofroi përshkrimin e sulmuesit dhe tregoi në hollësi detajet e sjelljes së tyre si në vijim: *”(...) ata e kishin dërguar gjyshin tim në një dhomë tjetër për ta maltretuar. (...) ata i kishin lidhur mbulesën rreth qafës së gjyshit dhe e dërguan atë në kuzhinë për ta maltretuar. I dyti, i treti dhe i katërti po e maltretonin atë ndërsa i pari po na ruante që të mos shihnim gjë. (...) pas një kobe ata ikën. Ne nxituam për në kuzhinë për të parë gjyshin i cili po luftonte për jetë. Nëna ime dhe unë shkuam tek fqinjët për të bërë një telefonatë dhe nuk u kthyem më në shtëpi. Gjatë gjithë kësaj kobe gjyshi mbeti në shtëpi i shtrirë në dysheme dhe duke pështyrë gjak.*

Trupi gjykues ka marrë parasysh gjithashtu deklaratën e dhënë nga Valentina Alsentijević, gjatë një hetimi, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/17 mbi pranueshmërinë e deklaratave të caktuara të dëshmitarëve gjatë hetimeve paraprake.

Ballafaquar me deklaratën e saj të mëparshme, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor të datës 28 korrik 2009, dëshmitarja i ka ofruar panelit shpjegimin e dëshmitarit okular të ngjarjeve të 2 gushtit 1999. Dëshmitarja tregoi në hollësi se atë ditë sulmuesit erdhën në shtëpinë e tyre, ata e ndanë atë dhe nënën e saj nga gjyshi, i cili është mbajtur në kuzhinë. Kjo dëshmitare pranoi haptazi se: *”Unë nuk kam mundur të dëgjoj asgjë, nuk kam qenë në gjendje të shoh asgjë, ne ishim në dhomë”* dhe ajo dhomë kishte në mes korridorin. Pastaj ajo rrëfeu si në vijim: *”Ai kishte mbulesën e bardhë të tavolinës rreth qafës (...) kur nëna ime i zgjidhi mbulesën e tavolinës atij i doli gjak nga goja dhe hunda (...) ishte tepër vonë të thërrisje ambulancën, nuk kishte kohë, gjyshi im pështynte gjak në lavaman (...) ai filloi të ecte drejt meje dhe nënës time për të na përqaftuar dhe ne po qëndronim afër koshit të plebrave dhe aty është vendi ku ai mbeti (...).Më pastaj dëshmitarja konfirmoi se gjyshi i saj ka vdekur dhe është varrosur në Prishtinë.*

Duke i vlerësuar këto deklarata është e qartë se ato janë të qëndrueshme deri në një shkallë të lartë. Gjithashtu saktësia e deklaratës është poashtu mbresëlënëse, duke pasur parasysh kalimin e kohës prej 10 viteve, që kur ka ndodhur krimi. Është e qartë se kjo dëshmitare ka përjetuar stres të skajshëm, përderisa kur është marrë në pyetje para gjykatës ishte hutuar jo vetëm për faktin, se nëse ajo ka dhënë një deklaratë gjatë hetimit, por gjithashtu dhe për atë se kë kanë njohur ajo dhe nëna e saj gjatë defilimit të identifikimit. Duhet të theksohet se është e natyrshme dhe e ditur nga të gjithë se njerëzit i mbajnë në mend më mirë ngjarjet menjëherë pasiqë ato të kenë ndodhur, se sa pas 10 viteve. Për më tepër, nuk mund të harrojmë se Valentina Alsentijević ishte fëmijë i vogël, kur ka ndodhur ky incident tragjik,

dhe ajo ka vuajtur trauma të rënda psikologjike nga të cilat ajo është shëruar, pasi që ajo ishte shumë e afërt me gjyshin e saj. Si pasojë ajo madje pati humbur aftësinë për të folur për një periudhë të caktuar kohore. Për shkak të rrethanave të sipërpërmendura paneli ka bërë një analizë të plotë të shpjegimit të ofruar nga kjo dëshmitare, duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Trupi gjykues nuk ka kurrfarë dyshimesh për sa i përket besueshmërisë së kësaj dëshmitareje dhe vërtetësisë së deklaratave të saj, pasi që ato vërtetohen nga përshkrimi i ngjarjeve të bërë nga Jorgovanka Milenković. Duhet të bëhet një vërejtje për sa i përket pyetjeve sugjestive parashtruar nga mbrojtja lidhur me defilimin e identifikimit dhe personit të identifikuar nga të dy dëshmitaret okulare. Është e qartë për trupin gjykues se deklaratat e dhënë si përgjigje ndaj pyetjes, nëse Valentina Alsentijević dhe nëna e saj e kanë njohur vetëm njërin njeri dhe atë me flokë të gjata, nuk mund të merret parasysh si e besueshme, pasi që e vetmja dëshmi në këtë çështje është deklarata e dhënë nga Jorgovanka Milenković, më 4 gusht 1999. Është mjaft e pahijshme të sfidohet njohuria e një dëshmitari duke iu referuar ngjarjeve, të cilat janë vërtetuar përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm, të bëra me qëllim të qartë për të ulur vërtetësinë e atij dëshmitari.

Dëshmia tjetër e rëndësishme në këtë rast ishte deklarata e dëshmitarit Budimir Milenković. Duhet të përmendet se Budimir Milenković nuk ishte dëshmitar okular i kësaj tragjedie dhe çdo gjë që ai di rreth saj, ishte bartur nga anëtarët tjerë të familjes, e që janë Jorgovanka Milenković dhe Valentina Alsentijević. Ai ka konfirmuar se personat që kanë hyrë me forcë, kanë ardhur në shtëpi për të kërkuar armë dhe e kanë maltretuar Momčilo Milenkovićin, pas atij sulmi Momčilo Milenković vdiq dhe Svetomir Milenković u zhduk. Sipas këtij dëshmitari, motra e tij Jorgovanka Milenković është marrë në pyetje nga KFOR-i pas asaj ngjarjeje dhe ka treguar njërin nga këta sulmues me allçinë në dorën e tij si njërin nga personat që kanë hyrë me forcë. Sipas këtyre fakteve, deklarata e Budimir Milenkovićit mbështet deklaratën e dhënë nga Jorgovanka Milenković, megjithëse nuk ka shumë detaje. Kjo është e qartë pasi që ai nuk ka qenë i pranishëm gjatë ngjarjes tragjike të 2 gushtit 1999, shpjegimi i është dhënë atij para 10 viteve, kështu që ai thjesht mund të ketë harruar disa hollësi detajesh të incidentit. Por kjo nuk është fare arsye për të vënë në dyshim besueshmërinë dhe vërtetësinë e deklaratës së tij, pasi që është e natyrshme se memoria dobësohet pas një periudhe prej 10 viteve. Pika kryesore është se esenca e dëshmisë së tij është absolutisht e qëndrueshme me deklaratën e Jorgovanka Milenkovićit. Bazuar në përshkrimin e qartë të bërë nga dëshmitarët Budimir Milenković dhe Jorgovanka Milenković, nuk ka kurrfarë dyshimi për sa i përket faktit se më 2 gusht 1999, në shtëpinë e tyre kanë hyrë me forcc0235 personat, e kanë rrahur Momčilo Milenkovićin, i cili vdiq më vonë dhe Svetomir Milenković, u zhduk pa asnjë gjurmë.

Deklarata e dhënë nga Budimir Milenković është e një rëndësie vendimtare, pasi që ai na ka treguar vendin se ku është varrosur Momčilo Milenković dhe më e rëndësishmja ai e ka njohur trupin e babait të tij në kasetën VHS, të incizuar në vendin e krimit.

Në përgjithësi, deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e sipër përmendur, i kanë lejuar trupit gjykues të rikrijojnë rrjedhën e ngjarjeve që kanë ndodhur më 2 gusht 1999. Analiza të mëtejme, bazuar në dëshmitë e mbledhura nga KFOR-i kanë çuar në përfundimin e qartë se i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani është arrestuar më **3 gusht 1999**, pra një ditë pas kryerjes së krimeve të pretenduara. Para se të merret parasysh kjo përmbledhje provash, duhet të bëhet një vërejtje e përgjithshme mbi pranueshmërinë. Gjykata Supreme e Kosovës

me vendimin e datës 17 prill 2001, ka prishur aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 20 mars 2000 dhe e ka kthyer rastin për rigjykim. Në arsyetim theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përbën shkelje fundamentale të dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 364 paragrafit 11 të Ligjit mbi Procedurën Penale. Është theksuar qartë se gjykata i ka lajmëruar palët se në një aktvendim të veçantë të datës 23 shkurt 2000, se mund të bëjnë ankesë, ka ndarë një numër të dokumenteve të rastit, megjithëse ky vendim nuk iu është dorëzuar palëve asnjëherë. Edhe një herë gjykata merr një vendim tjetër mbi ndarjen e dokumenteve të rastit, por nuk është theksuar cilat dokumente ishin ndarë siç arsyetohet në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 17 prill 2001. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës ka lënë udhëzime të qarta për procedurën e mëtejme. Sipas tyre, gjatë rigjyimit duhet të mblidhen dhe ekzaminohen të gjitha dëshmitë veç e veç dhe në mbështetje të njëra tjetrës, duke pasur parasysh eliminimin e shkeljes fundamentale të procedurës penale dhe duke pasur parasysh argumentet tjera të paraqitura në ankesa.

Në pajtim me nenin 390(3) të Ligjit mbi procedurën Penale: *“Gjykata e shkallës së parë duhet të zbatojë të gjitha procedurat dhe të shqyrtojë të gjitha çështjet e diskutueshme, të cilat janë cituar nga gjykata e shkallës së dytë në vendimin e saj”.*

Sipas mendimit të këtij trupi gjykues, nuk ka qenë e nevojshme që të ndahen provat e mbledhura nga KFOR-i, mbi bazat e nenit 83 të Ligjit mbi Procedurat Penale për arsyet në vijim. Thuhet në nenin 83, artikullin 1 se gjyqtari hetues do të përjashtojë nga të dhënat, deklaratat e të akuzuarit, të dëshmitarit dhe të dëshmitarit ekspert mbi të cilat sipas Ligjit mbi Procedurën Penale, nuk mund të mbështetet aktgjykimi. Komentimi i Momcilo Grubac & Tihomir Vasiljevic për ligjin mbi procedurën penale 1982, botimi i 2-të “Savremena Administracija”, Beograd duhet të citohet: *“Marrja në pyetje e të akuzuarit nuk mund të jetë bazë për një vendim gjykatë, nëse marrja në pyetje bëhet pa praninë e avokatit mbrojtës. Avokati mbrojtës mund të mos jetë i pranishëm vetëm nëse i akuzuari i heq këtë të drejtë në mënyrë të qartë dhe nëse avokati mbrojtës nuk është i obligueshëm apo nëse ligji parashkruan se avokati mbrojtës nuk mund të ndjekë procedurën hetimore (neni 168, paragrafi 5), apo nëse avokati mbrojtës nuk është i pranishëm edhe pse ai është njoftuar për hetimin, apo nëse i akuzuari nuk ka marrë një avokat mbrojtës për marrjen e parë në pyetje në afat prej 24 orëve pasi që është informuar për mjetet ligjore, të pranojë në rast të mbrojtjes së detyrueshme. Vendimi i gjykatës nuk mund të bazohet në marrjen në pyetje të të akuzuarit nëse ai është detyruar me forcë, është kërcënuar apo dhe në mënyra tjera (neni 259, paragrafi 3) të japë deklaratë apo të pranojë, apo nëse deklaratat e tij në lidhje me praninë e avokatit mbrojtës nuk është futur në procesverbal (neni 218, paragrafit 9 dhe 10).*

*Vendimi i gjykatës nuk mund të bazohet në marrjen në pyetje të dëshmitarit nëse personi i cili ka dëshmuar nuk duhet të dëgjohet si dëshmitar (neni 226) apo nëse dëshmitari i marrë në pyetje, të cilit i është hequr obligimi për të dëshmuar, por të cilit nuk i është hequr e drejta në mënyrë të qartë apo nëse deklaratat e tij mbi atë çështje nuk është shënuar në procesverbal apo nëse dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, përmes kërcënimit apo mjeteve tjera të ngjashme (nenet 227, 228).*

*Vendimi i gjykatës nuk mund të mbështetet në një deklaratë të një dëshmitari ekspert, nëse ekspertiza është bërë nga një person, i cili nuk mund të jetë dëshmitar ekspert, sipas ligjit (neni 244, paragrafi 1).”*

Duke marrë parasysh vlerësimet e përmendura ligjore, të cilat i ndan ky panel plotësisht, nuk kishte dhe akoma nuk ka baza ligjore për të ndarë nga dosja e rastit deklaratat e dhëna nga Jorgovanka Milenković, Valentina Alsentijević, Abdyl Dibrani dhe Enver Kastrati.

Ky trup gjykues nuk ka gjetur ndonjë bazë ligjore që të përjashtojë nga dosja e rastit shkresat, informatat dhe shënimet zyrtare (të përmendura në propozimin e prokurorit publik për të përfshirë dokumente në të dhëna, të datës 4 gusht 2009, artikujt nga 1 deri në 27) të mbledhura gjatë hetimeve pasiqë këto dokumente ishin mbledhur nga agjencioni për zbatimin e ligjit, në pajtim me nenin 151 të Ligjit mbi Procedurën Penale së bashku me Paragrafin 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/1 mbi autoritetin e administrimit të përkohshëm në Kosovë. Këto dokumente konfirmojnë veprimet që janë ndërmarrë gjatë hetimeve, të cilat kanë rezultuar në kapjen e të pandehurit.

“Raporti Fillestar i Rastit” i datës 8 maj 1999 i autorizuar nga EJ Woolbridge, thekson qartas se rreth orës 8.00 të martën më 3 gusht 1999, pesë burra shqiptarë janë kapur nga trupat e KFOR-it Italian në rrethinën e Pejës, 80 km në perëndim të Prishtinës (ekzemplari Nr.1 nga lista e prokurorisë). Kjo provë, për sa i përket datës së arrestimit, mbështetet nga formulari i arrestimit për Dibranin, Kastratin, Berishën, Sahitin and Hajdarin (ekzemplari Nr.1 dhe 10 nga lista e prokurorisë), Vërtetimi i regjistrit të burgut dhe letra kthyesë e datës 04.05.1999 nga Vittorio De Stasio dhe Emilio Della Sala, (tri faqe italisht, shqip dhe anglisht), (ekzemplari Nr.17 nga lista e prokurorisë), Vërtetim i fletëshënimit të burgut dhe letra kthyesë; nga Vittorio De stasio (shënuar faqja e përkthyer 17) (tri faqe italisht, anglisht dhe shqip), (ekzemplari Nr.21 nga lista e prokurorisë), Regjistri i burgut i datës 04.08.1999 (tri faqe, italisht, anglisht dhe shqip), (ekzemplari Nr.22 nga lista e prokurorisë). Për sa i përket deklaratës së detyrave të kryera më 3 gusht, 1999 nga WO Gianluca Basso (ekzemplari Nr.11 nga lista e prokurorisë, dosja II, paragrafi 30) dhe deklarata e Paraburgimit të Përkohshëm më 3 gusht, 1999 nga WO Gianluca Basso (ekzemplari Nr.12 nga lista e prokurorisë, dosja II, paragrafi 30) se tërë këta burra janë arrestuar më 3 gusht 1999.

Përveç provës së propozuar nga prokuroria, ky panel ka ndërmarrë veprimin e mëtejshëm evidentues me qëllim të konfirmimit të datës në të cilën është kapur i pandehuri. Si rezultat i kësaj kërkese, letra e KFOR-it dhe lista e vërtetuar e paraburgimit (nr. ref. 0610/DOS KV101/09) e datës 9 dhjetor 2009 nga M Scholze dhe Istvan Kokics (dosja II, paragrafi 3) dhe Letra dhe dokumentet e bashkëngjitura (dosja II, paragrafi 11) nga Bajram Zymberi më datën 20 gusht 2009 me nr. ref. 0973/09, që do të thotë janë pranuar, Certifikata e Arrestimit dhe Paraburgimit, Paragrafi i karakteristikave të të paraburgosurit dhe dënimi dhe një kopje e fotografisë e shënuar P 443/99 Berisha, Besim më datën 2/11/1999.

Bazuar në këtë provë trupi gjykues nuk ka kurrfarë dyshimi se i pandehuri Besim Berisha, është arrestuar më 3 gusht 1999. Provat e mbledhura në këtë çështje janë të logjikshme, të besueshme dhe vet-shpjeguese. Për më tepër Gianluca Basso – njëri nga zyrtarët e Policisë Italiane, i cili është marrë në pyetje si dëshmitar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më datën 8 dhjetor 2009, ka konfirmuar se i pandehuri është arrestuar më datën 3 gusht 1999. Trupi gjykues nuk ka kurrfarë arsyesh të dyshojë për sa i përket besueshmërisë së këtij dëshmitari dhe vërtetësisë së deklaratës së tij. Gianluca Basso ka kujtuar të gjitha faktet e rëndësishme, madje edhe duke pasur parasysh kohën që kishte kaluar. Ky dëshmitar është marrë në pyetje përmes video konferencës, pasiqë ai shërben në Iran, pasiqë ai nuk ka qenë në gjendje të paraqitet para gjykatës – neni 284(1) i Ligjit mbi Procedurën Penale.

Në bazë të provave të lartpërmendura, mbrojtja e të pandehurit që ka pohuar se ai nuk ka mundur të kryejë krimet për të cilat akuzohet, pasiqë ai ishte arrestuar më 2 gusht 1999, duhet të konsiderohet si një tentim të padobishëm për t’iu shmangur përgjegjësisë penale.

Avokatët mbrojtës janë paraqitur me provën të numëruar nga 1 deri në 6 (shih listën e sipër përmendur) me qëllimin e deklaruar të vërtetimit se i pandehuri ishte arrestuar më 2 gusht 1999, me fjalë tjera ai nuk ka mundur të kryejë veprat penale për të cilat akuzohet. Ky tentim duhet të konsiderohet si i padobishëm, pasiqë prova nuk ka kurrfarë lidhjeje në këtë aspekt. Nga pikëpamja ligjore, shkrimet e propozuara gjyqësore nuk do të konsiderohen si të kishin fuqi provuese; thjesht ato nuk provojnë se kur është arrestuar i pandehuri, pasiqë ato nuk janë material burimor. Subjekti i vetëm ligjor i caktuar për të treguar kur ishte arrestuar i pandehuri është agjencioni për zbatimin e ligjit, që e ka arrestuar atë dhe qendra e paraburgimit ku është mbajtur ai.

Trupi gjykues nuk ka kurrfarë dyshimesh se Besim Berisha aka Burim Dibrani ishte në mes të personave që kanë hyrë me forcë, të cilët më 2 gusht 1999 kanë sulmuar shtëpinë e Momčilo Milenkovićit, e kanë rrahur atë dhe e kanë lënë në një gjendje në rrethana të rrezikut për jetë. Prova vendimtare në lidhje me të ishte deklarata e dhënë nga dëshmitarja Jorgovanka Milenković, e cila jo vetëm që e njohu atë gjatë një sfilate për identifikim, por së pari ka dhënë përshkrim të plotë të fajtorëve së bashku me tiparin e tij dallues që është të themi allçia në dorën e tij. Për më tepër fotografitë e printuara me ngjyrë të dorëzuara nga zyra e prokurorisë më 23 nëntor 2009 (dosja Nr. II, paragrafi 5) në mes të të cilave fotografia B përshkruan të pandehurin, përtej dyshimeve largon çdo kundërshtim se i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani ishte arrestuar nga policia Italiane e KFOR-it. Fotografitë janë konsideruar si të besueshme, pasiqë ato janë marrë menjëherë pas arrestimit nga KFOR-i – subjekt i pavarur ndërkombëtar përgjegjës për zbatimin e ligjit.

Deklaratat e dëshmitarëve Jorgovanka Milenković dhe Gianluca Basso kanë vërtetuar pa asnjë dyshim të arsyeshëm se i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani, në ditën kritike e kishte dorën e majtë në allçi. Kjo rrethanë është konfirmuar gjithashtu nga prova tjera, pra: fletëlëshimi me epikrizë me numër 1354 lidhur me të pandehurin, nënshkruar nga Dr. Blerim Qosaj, (dosja II, paragrafi 30), deklarata e Dr. Blerim Qosaj, i marrë në pyetje si dëshmitar më 24 nëntor 2009 dhe letra dhe dokumentet e bashkëngjitura nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, të datës 21 tetor 2009 (nga Prof. Ass. Faton Morina), kopja e e librit të administratës për datën 6 korrik 1999 (volumi II, paragrafi 7). Kjo provë objektive nuk e ul besueshmërinë e deklaratës së Jorgovanka Milenkovićit për sa i përket se në cilën dorë kishte allçinë i pandehuri. Jorgovanka Milenković pohoi si në vijim: *”Ky burrë kishte allçi në krahun e tij të djathtë siç më është dukur mua. Katër nga gishtat e tij ishin të mbështjellur me allçi, ndërsa gishti i madh i mbështjellur ndaras me allçi. Ai kishte allçi deri në gjysmë të krahut. Allçia ishte shumë e bardhë dhe e pastër”*. Duhet të theksohet se në atë ditë kritike, dëshmitarja i është ekspozuar një stresi ekstrem, në situatë kërcënuese për jetën, pra konfuzioni i mundshëm për sa i përket anës së lëndimit nuk është vendimtar. Ky shpjegim i përgjithshëm i kësaj dëshmitare korrespondon me të dhënat mjekësore të të pandehurit që e bën dëshminë e Jorgovanka Milenković-it edhe më të besueshme.

Për shkak të faktit se fletëlëshimi së bashku me epikrizën ishte lëshuar për Burim Dibrani e jo Besim Berishën, trupi gjykues është dashur të ndërmarrë veprime të mëtejme që të largojë dyshimin e arsyeshëm, nëse dokumenti i dorëzuar është përgatitur në përputhje me procedurat në fuqi në atë kohë dhe nëse i pandehuri ka përdorur dy emra – Besim Berisha dhe Burim Dibrani.

Pas leximit të, letrës dhe dokumenteve të bashkëngjitura nga Ministria e Punëve të Brendshme (nga Blerim Camaj) të datës 27 tetor 2009, formularit të aplikimit të titulluar “Regjistrimi civil dhe i votuesve” më datën 15/07/2000, fotografisë së skanuar dhe zmadhuar, shenjave të gishtave (2) dhe certifikatës origjinale të lindjes, trupi gjykues nuk ka kurrfarë dyshimesh për sa i përket identitetit të dyfishtë të të pandehurit. Është e qartë se i pandehuri në lindje ka marrë emrin Burim Dibrani dhe gjatë jetës së tij ai ka përdorur gjithashtu emrin Besim Berisha. Kur ai ka aplikuar për letërnjoftim, më datën 15 korrik 2000, i pandehuri ka përdorur emrin nga lindja Burim Dibrani, çka është e qartë me një veprim të thjeshtë të krahasimit të pamjes së fundit me fotografinë e bashkëngjitur në kërkesën e tij për letërnjoftim. Ai gjithashtu ka përdorur emrin Burim Dibrani kur ka kërkuar trajtim mjekësor.

Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve në vijim Blerim Qosaj, Jusuf Ulaj, Bedri Bakalli dhe pas analizimit të raportit mbi ekzaminimin fizik të të pandehurit dhe raportin mjekësor të mjekësisë ligjore nga dëshmitarët ekspert Dr. Marek Gasior dhe Dr. Tefik Gashi, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se fletëlëshimi me epikrizë është një dokument i besueshëm që vërteton gjendjen fizike të të pandehurit, në kohën kur janë kryer krimet e pretenduara.

Një çështje tjetër, që është dashur të merret parasysh nga trupi gjykues, ishte të shqyrtohej nëse i pandehuri me dorën e majtë në allçi ka qenë në gjendje të rrah dhe maltretojë Momčilo Milenkovićin. Mendimi i dëshmitarëve ekspert të sipër përmendur, së bashku me vërejtjet e bëra nga kryetari i trupit gjykues, shënuar në procesverbalin e datës 10 nëntor 2009, (versioni anglisht faqja 2) se Besim Berisha ka nënshkruar dokumentin me dorën e djathtë, i ka lejuar trupit gjykues që pa dyshimin më të vogël të arrijë në përfundimin se i pandehuri, madje edhe me dorën e majtë në allçi ka qenë në gjendje të kryej një veprim armiqësor kundër viktimës së ndjerë. Trupi gjykues ka gjetur se deklarata e dhënë nga i pandehuri se gjatë kohës kur ai është plagosur ai ishte majtak dhe për shkak të këtij fakti ai më vonë filloi të përdor dorën e djathtë për aktivitete të përditshme, një tentim i pabazuar dhe i padobishëm për t’i ikur përgjegjësisë penale. Madje edhe nëse dikush mund të miratoj pozitën e të pandehurit se ai ishte majtak, është çështje e arsytimit logjik dhe të kuptuarit të përgjithshëm se një veprim i tillë si rrahja nuk kërkon precizitet adekuat dhe mund të kryhet me dorë të djathtë. Për më tepër, duhet ta kujtojmë se i pandehuri nuk ka vepruar vetëm gjatë rrahjes së Momčilo Milenkovićit, por së bashku me një person tjetër të panjohur.

Çështja më e rëndësishme faktike që është dashur të përcaktohet, përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm, sipas pikave 1 dhe 3 të aktakuzës së ndryshuar, ishte shkaku i vdekjes së Momčilo Milenkovićit. Në lidhje me këtë çështje janë marrë parasysh provat në vijim: kaseta VHS e bërë në skenën e krimit, deklarata e dëshmitarit Brendan Tanslen (dosja II, paragrafi 27), letra e informimit lidhur me ekzaminimin post-mortem të z. Milenković, nga Zyret Qendrore të Brigadës Shumëkombëshe (Qendra) Prishtinë (dosja II, paragrafi 19), informatat për kufomën e Momčilo Milenkovićit që është nxjerrur nga spitali (dosja II, paragrafi 12), raporti mjekësor i Momčilo Milenkovićit, i datës 6 nëntor 1999 (dosja II, paragrafi 7), të dhënat mjekësore (dosja II, paragrafi 8), raporti i autopsisë i datës 11 tetor 2009 (dosja III, paragrafi 21), opinionioni mjeko-ligjor numër P. Nr.97/01 i datës 29 tetor 2009 (dosja III, paragrafi 17), ekzaminimi i dëshmitarit ekspert gjatë shqyrtimit gjyqësor. Vdekja e Momčilo Milenkovićit si rezultat i incidentit të përshkruar në pikën 3 të aktakuzës së ndryshuar është një fakt i padiskutueshëm. Deklaratat e Jorgovanka Milenkovićit dhe Valentina Aksentijevićit janë të qarta, logjike dhe të plota për sa i përket këtij fakti. Si shtesë, dëshmitari, Budimir Milenković, pas prezantimit të filmit të bërë në vendin e krimit, ka

konfirmuar se ai kishte njohur trupin e babait të tij të vdekur Momčilo Milenković. Është e qartë se kurrfarë dyshimesh reale dhe logjike nuk mund të ekzistojnë për sa i përket faktit se Momčilo Milenković, ka vdekur në rrethanat e përshkruara në pikën III të aktakuzës së ndryshuar.

Ekziston një arsye e mirë për të besuar se gjatë veprimeve hetuese të bëra pas një kohe të shkurtër pas incidenteve të ditës kritike, është bërë një mospërfillje e madhe e detyrave profesionale.

Së pari, hetuesit nuk kanë bërë fotografi, ku do të përshkruanin skenën e krimit dhe trupin e viktimës së ndjerë, në vend të kësaj është bërë një incizim i turbullt. Sipas mendimit të trupit gjykues, fotografitë e përgjithshme të trupit të Momčilo Milenkovićit do të kishin qenë të dobishme për të përcaktuar, në detaje, të gjitha lëndimet që ai ka marrë, të njëjtën kohë për të zbuluar shkakun e vdekjes.

Së dyti, trupi i Momčilo Milenkovićit i është dorëzuar familjes pa bërë ekzaminimin post-mortem. Në mungesë të kësaj dëshmie vendimtare, dëshmitarët ekspert nuk kanë qenë në gjendje, që t'i sigurojnë trupit gjykues mendimin e qartë të tyre mbi shkakun e vdekjes së Momčilo Milenkovićit.

Me qëllim të përcaktimit të vërtetës objektive – arsyes së vdekjes së Momčilo Milenkovićit, trupi gjykues pati vendosur të zhvarrosen mbetjet mortore të Momčilo Milenkovićit dhe të bëhet autopsia post-mortem. Duke pasur parasysh deklaratat e dëshmitarëve okular, kryesisht pjesës që ka të bëjë me mbulesën e tavolinës, e cila ishte mbështjellur shtërngueshëm rreth qafës së të ndjerit, trupi gjykues ka dashur që të ekzaminohen mbetjet mortore me qëllim të vërtetimit të çfarëdo lëndimi të shkaktuar para vdekjes. Për sa i përket raportit të autopsisë nënshkruar nga dëshmitari ekspert, Dr. Marek Gasior: *"Pasiqë nuk kemi inde të buta dhe eshtrat e ekzaminuara nuk tregojnë kurrfarë dëshmish të lëndimeve të shkaktuara para vdekjes unë nuk mund të konstatoj shkakun e vdekjes. Prandaj bazuar në ekzaminimin e eshtrave të mbetjeve mortore të cilat më janë identifikuar si mbetjet mortore të Momčilo Milenković-it, shkakun e vdekjes duhet të mbetet i pa konstatuar".* Studimi i mëtejshëm i provave të mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor, veçanërisht deklaratat e Budimir Milenkovićit, ka sjellur para vëmendjes së gjykatës se Momčilo Milenković ka pasur probleme shëndetësore për një kohë të gjatë para vdekjes së tij. Trupi gjykues ka marrur si provë të dhënat mjekësore të të ndjerit Momčilo Milenković, nga Arkivi Shtetëror i Kosovës. Në bazë të dëshmisë së lartpërmendur, dëshmitarët ekspert kanë përgatitur mendimin e tyre mjeko-ligjor më datën 29 tetor 2009, në të cilin ata gjetën: *"të konstatohet shkakun e vdekjes së tij është shumë e vështirë. Por duke marrë parasysh sëmundjet e tij të mëparshme në sistemin e tij të qarkullimit dhe faktin se ai është rrahur dhe ka vdekur gjatë apo menjëherë pas trazirës ka shumë të ngjarë se ai mund të ketë vdekur si shkak i plaçkitjes apo stresit në lidhje me aritminë e zemrës. Në nuk mund të përjashtojmë gjithashtu se vdekja ka mund të jetë rezultat i asfiksionit posturale. Në kemi marrë parasysh gjithashtu dhe pushimin kardio respirator lidhur me përpjekjet, kufizimi i pozitës së personit me sëmundje të mëparshme të sistemit të qarkullimit."*

Veç kësaj dëshmitarët ekspert janë ftuar në shqyrtimin gjyqësor me qëllim që t'i sigurojnë trupit gjykues, informata shtesë në lidhje me vdekjen e Momčilo Milenkovićit. Duhet të theksohet në mënyrë të qartë se dëshmitarët ekspert mbështetën opinionet e tyre me shkrim dhe përsëritën edhe njëherë se pa autopsi, si një testim laboratorik, ata nuk kanë mundur të përcaktojnë me siguri shkakun e drejtpërdrejtë të vdekjes. Të gjitha shkaqet e vdekjes që ata kanë paraqitur duhet të merren parasysh si shumë të mundura por jo të sigurta. Mendimi

është gjithashtu i qartë në lidhje me çështjen nëse ka patur lidhje në mes të veprimeve të të pandehurit dhe shkakut të vdekjes. Ekspertët kanë deklaruar se nuk kishte kurrfarë lidhje (lidhje të rastit) të atij lloji dhe këto veprime duhet të konsiderohen vetëm në këtë mënyrë se e kanë keqësuar ose kanë ndodhur më shpejt “accasio” dhe “conditio” mortis, që janë përcaktuar me siguri. Duke iu referuar pyetjes nëse nga ana mjekësore, situata në të cilën ishte vendosur Momčilo Milenković, mund të vlerësohet si situatë e rrezikshme për jetën, mendimi ishte tepër preciz- në qoftë se kemi të bëjmë me infarkt si pasojë e situatës me të cilën është përballur Momčilo Milenković - situata e llojit të tillë konsiderohet si situatë e rrezikshme për jetën dhe ndihma mjekësore në këtë rast duhet të jetë e shpejtë, urgjente dhe profesionale.

Trupi gjykues e pranon plotësisht mendimin mjeko-ligjor, raportin mbi ekzaminimin mjekësor dhe raportin e autopsisë si të qartë dhe të besueshëm. Dëshmitarët ekspert dhanë mendimin e përgjithshëm dhe të besueshëm dhe raportet bazuar në bazë të njohurive të gjera dhe të specializuara të profesionistëve të përkushtuar dhe me përvojë.

Për sa i përket raportit të shenjave të gishtave të bërë nga Kevin J Miller, rreshter i Policisë së Kalorësisë Mbretërore Kanadeze, sipas mendimit të trupit gjykues nuk ka pasur kurrfarë arsye që të dëmtohet besueshmëria e kësaj dëshmie, pasi që ai është përgatitur në mënyrë profesionale dhe të besueshme. Duhet të bëhet një koment lidhur me këtë dëshmi, dmth sipas nenit 347 të Ligjit mbi Procedurën Penale, gjykata ka për detyrë të vlerësojë me ndërgjegje çdo pjesë të dëshmimeve, veçmas dhe në lidhje me njëra tjetrën dhe në bazë të këtij vlerësimi, të përpilohet një vlerësim nëse është vërtetuar fakti. Kjo dëshmi e marrë veçmas nga grupi i dëshmimeve nuk duhet të përdoret si bazë për të liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat. Ky mendim për shenjat e gishtave duhet të merret parasysh në lidhje me dëshmitë tjera të pranuar gjatë shqyrtimit gjyqësor veçanërisht me deklaratat e Jorgovanka Milenkovićit dhe Gianluca Basso. Për më tepër, mënyra shumë joprofesionale me të cilën janë mbledhur provat në skenën e krimit, siç është përmendur më parë, jep arsye për të hedhur dyshimin se jo të gjitha shenjat mundshme të jenë mbledhur.

Deklarata e Enver Kastratit, më datën 5 gusht 1999, dhënë Rreshterëve Roberts dhe Floats nuk është marrë parasysh kur është vendosur mbi përgjegjësinë e të pandehurit, pasi që ishte e paqartë se në çfarë pozite ishte marrur në pyetje ai në atë kohë. Në titullin e procesverbalit të marrë gjatë marrjes në pyetje, është treguar se procesverbali përmban deklaratën e dëshmitarit, por në anën tjetër udhëzimi për obligimin e dëshmitarit është tejkalluar, që do të thotë se ai ka mundur të jetë marrë në pyetje si i dyshuar. Duhet të theksohet se sipas nenit 195 të Ligjit mbi Procedurën Penale, nëse ka patur dyshime se Enver Kastrati ka kryer një vepër penale ai është dashur të kapej dhe të sillej, pa vonesë, para gjyqtarit hetues kompetent në juridiksionin e të cilit ishte kryer vepra penale. Duhet të vërehet, se siç dihet në përgjithësi se Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe gjyqtari hetues i kësaj gjykate ishin duke vepruar. Për më tepër, procesverbali nuk përmban informata nëse ai është informuar për të drejtat e tij si i dyshuar. Për shkak të dykuptimësisë së paraqitur, në favor të të pandehurit, trupi gjykues nuk ka mundur dhe nuk i ka mbështetur të gjeturat e tyre në këtë deklaratë. Duhet të theksohet qartazi se dëshmitë tjera janë përdorur për të vërtetuar situatën faktike të kësaj dite kritike.

Për sa i përket deklaratave të dhëna nga Enver Kastrati më 14 tetor 1999, gjatë shqyrtimit gjyqësor më 20 mars 2000 dhe sidomos gjatë rigjyqimit më 5 gusht 2009, sipas mendimit të

trupit gjykues ato janë krejtësisht të pakonceptueshme dhe të anshme. Enver Kastrati arriti deri në atë shkallë, të thënies së gënjeshtrove para gjykatës. Ky dëshmitar gënjeu për sa i përket datës kur ata janë zënë dhe paraqiti se kjo ka ndodhur më 2 gusht 1999. Është tepër e papranueshme të mbahet në mend pas 10 viteve dita e saktë në të cilën janë arrestuar ata, pasi që është e natyrshme se njerëzit kanë tendencë për të harruar me kalimin e kohës. Sqarimi që ai paraqiti është plotësisht i pabesueshëm, pasi që mospërputhjet u paraqitën në mes të deklaratave të tij. Duhet të theksohet se gjatë marrjes në pyetje të datës 14 tetor 1999 dhënë para gjyqtarit hetues ai deklaroi: ” *Nuk më kujtohet data e saktë por sigurisht duhet të ketë qenë diku në fillim të muajit të tetë (8) të vitit pasi që unë isha për një pushim të shkurtër në shtëpi.*” Meqenëse gjatë marrjes në pyetje të kryer 2 muaj pas incidentit, atij nuk i kujtohej dita e saktë e arrestimit, është e pamundur të kujtosh këtë datë 10 vjet më pas. Trupi gjykues është i mendimit se dëshmitari, Enver Kastrati, gënjeu me qëllim që t’i sigurojë të pandehurit një alibi të fortë, për datën e 2 gushtit 1999. Një sjellje e tillë është e dënueshme, për të cilën Enver Kastrati, duhet të ndiqet penalisht.

Deklarata e Avdyl Dibranit, i cili u mor në pyetje më 31 gusht 1999 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor më 20 mars 2000 paraqiti se ai së bashku me Besim Berishën dhe 3 burra të tjerë ishte arrestuar më 2 gusht 1999, është vlerësuar si shumë e pambështetur dhe e njëanshme. Arsyeja për këtë vlerësim ishte fakti se Avdyl Dibrani dhe i pandehuri kanë shërbyer së bashku në UÇK si ushtarë, kështu që është e qartë se ky dëshmitar kishte arsye të forta të jepte dëshmi në favor të të pandehurit. Për më tepër, duhet të vërehet se për sa i përket asaj se deklarata e dëshmitarit Avdyl Dibrani, në lidhje me datën e arrestimit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë dhe të qartë me provat tjera të besueshme është përpunuar më tej. Si shtesë, duhet theksuar, se ekziston një mospërputhje me deklaratat e këtij dëshmitari, pasi që kur është marrur në pyetje menjëherë pas incidentit ai deklaroi:” *Me sa më kujtohet, ishte 2.08.1999 (...)*” krahasuar me deklaratën e drejtpërdrejtë gjatë gjykimit të parë, se ai së bashku me të tjerët ishin arrestuar më 2.08.1999. Ishte e qartë se Avdyl Dibrani kishte ndërruar deklaratën e tij të mëparshme vetëm për një arsye – t’i ofronte të pandehurit një alibi të fortë.

Trupi gjykues ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të ftuar Avdyl Dibranin, kështu që për të përballur deklaratat që ai ka dhënë gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor. Sipas informatave të nënshkruara nga Guido Oestreich, nga Njësia për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar e EULEX-it, është e njohur vendndodhja e Avdyl Dibranit. Duke marrë parasysh këtë fakt, në bazë të nenit 333 paragrafit 1 pikës 1 të Ligjit mbi Procedurën Penale, trupi gjykues mori vendimin të pranojë deklaratat e datës 31 gusht 1999 dhe të datës 20 mars 2000. Duhet të bëhet vërejtje për sa i përket deklaratës së Avdyl Dibranit të dhënë më 5 gusht 1999. Trupi gjykues ishte i mendimit se deklarata e përmendur nuk i përmbush kërkesat e Rregullores Nr.2000/17 mbi Pranueshmërinë e Deklaratave të Caktuara të Dëshmitarëve në Hetimet Paraprake, pasi që Avdyl Dibrani ishte marrur në pyetje nga gjyqtari hetues më 31 gusht 1999.

Provat në vijim: raportet e deklaratave të Avdyl Dibranit, Hajdar Sahitit, Enver Kastratit, Besim Berishës më datën 3.08.1999 së bashku me listën e vërtetuar të paraburgimit, të datës 9 dhjetor 2009, të dorëzuara nga KFOR-i përbëjnë një zinxhir tjetër të provave, në mënyrë që të konfirmohet se data e vërtetë e të pandehurit dhe të burrave tjerë ishte 3 gusht 1999.

#### IV. Vlerësimi ligjor:

Pas shqyrtimit të provave materiale të përmendura dhe pas marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë procedurës gjyqësore, Gjykata gjeti se Besim Berisha aka Burim Dibrani është fajtor përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm për veprën penale Ekspozimi ndaj rrezikut në kundërshtim me nenin 42 paragrafin 2 të Ligjit Penal të Kosovës lexuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977), pasi që nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë veprë për të cilën ai akuzohej.

Në pajtim me nenin 350 paragrafin 3 të Ligjit mbi Procedurën Penale (Gazeta Zyrtare Nr. 26/86) i pandehuri Besim Berisha aka Burim Dibrani ishte liruar nga veprat penale të Vrasjes nga neni 30 paragrafi 2 artikulli 3 të Kodit Penal të Kosovës dhe Heqje e Paligjshme e Lirisë, neni 63 paragrafi 4 siç lexohet me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë;

Termi i përgjithshëm i veprës penale të vrasjes, definohet me ligj si jeta e një personi tjetër që merr apo shkatërron jetën e një personi tjetër. Në mesin e grupit të veprave penale kundër jetës apo trupit, njeriu duhet të bëjë dallimin në mes të: vrasjeve të kryera *me paramendim* dhe vrasjet *nga pakujdesia*.

Paragrafi 1 i nenit 47 përcakton dënimin për formën bazë të vrasjes së kryer me paramendim. Sipas nenit të përmendur veprimi me anën e të cilit kryhet vepra penale e vrasjes nuk është përcaktuar hollësisht, kështu që veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është çdo veprim me anë të të cilit është e mundur të shkaktohet vdekja e një personi tjetër. Pasi që ligji nuk përcakton mjetet e veçanta apo një mënyrë të posaçme të kryerjes, vrasja mund të kryhet me çfarëdo mjeti apo në çfarëdo mënyre që mund të shkaktojë vdekjen e personit tjetër. Vrasja mund të kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë dhe në çfarë do mënyre dhe mosvepruar.

Është e nevojshme të citohet qëndrimi ligjor nga komentit nga SRZENTIC, Nikola – STAJIC, dr. Aleksandar – KRAUS dr. BOZIDAR – LAZAREVIC, dr. Ljubisa – DJORDJEVIC, dr. Miroslav KOMENTI MBI LIGJET PENALE TË RS TË SERBISË, KSA TË KOSOVËS DHE KSA TË VOJVODINËS, 1981. "SAVREMENA ADMINISTRACIJA" BEOGRAD:"

*Vepra penale e vrasjes kryhet nga mosveprimi gjithashtu në disa raste kur ligji, duke përcaktuar një veprë penale si heqje e deliktit, parasheh vdekjen e një personi si një pasojë kualifikuese, por kjo pasojë nuk është sjellur nga neglizhenca por me paramendim. Pra, një veprë penale nuk mund të kualifikohet sipas nenit 57, paragrafit 2 (ekspozim ndaj rrezikut) apo sipas nenit 58, paragrafit 2 (braktisja e një personi të pambrojtur), por më parë do të kualifikohet sipas nenit 47 nëse kryerësi i veprës penale ka sjellur një person tjetër në një gjendje apo rrethana të rrezikut të jetës së tyre dhe pastaj të liben pa ndihmë, apo të lënë pa ndihmë një person të paafte i cili i ishte besuar apo ndaj të cilit përndryshe ai ishte i obliguar të kujdesej në situatë të rrezikut të jetës, me paramendim që personi tjetër të humb jetën e tij, dhe në të vërtetë personi i lënë humb jetën e tij."*

Sipas definicionit ligjor të paramendimit, marrja e jetës do të kryhej me paramendim nëse kryerësi i veprës penale është në dijeni se po ndërmerret një veprim me anë të të cilit është e mundur të vritet personi, se ky veprim është drejtuar ndaj një personi të gjallë (vetëdija e lidhjes së rastit) dhe nëse kryerësi dëshiron të marrë jetën e viktimës (paramendim i

drejtpërdrejtë) apo përmbajtjet ndaj pasojës së paraparë – vdekja e një personi (paramendim i rastit).

Varet nga gjykata të nxjerr një përfundim në bazë të gjithë rrethanave të lidhura me veprën dhe kryerësin e veprës në përcaktimin nëse kryerësi i veprës ka dashur apo jo që kjo veprë të kryhej ose jo.

Sipas mendimit të gjykatës mbështetur nga komentet ekzistuese, duhet të jepet mendimi se kryerësi i veprës ka dashur që vepra të kryhet nëse pasoja e veprës ishte qëllimi, synimi i veprës së tij. Përfshihen rastet kur të gjitha rrethanat drejtojnë kah përfundimi se kryerësi i veprës ka ndër marrë veprimin në mënyrë që të ndodhin këto rrethana. Duhet gjithashtu të konsiderohet se kryerësi i veprës e dëshiron veprën penale edhe kur rrethanat e veprës nuk janë qëllimi themelor, por një mjet për realizimin e një qëllimi tjetër.

Vepra është kryer me paramendim të rastit kur kryerësi i veprës ishte në dijeni se si pasojë e veprës së tij apo mos-veprës së tij, mund të ndodh një rrethanë e ndaluar, dhe ende ka pranuar ndodhjen e saj. Kjo formë e fajit përmban gjithashtu dijeninë dhe vullnetin, por me të dyja elementet ekziston një dallim i caktuar në lidhje me paramendimin e drejtpërdrejtë, për shkak të faktit se është disi më e shprehur si sjellje vullnetare. Për elementin e të qenit në dijeni dallimi qëndron në atë se për paramendimin e drejtpërdrejtë ekziston dijenia e sigurisë së veprës, dhe për paramendimin e rastit paraqitet dijenia e mundësisë së pasojës së veprës, në rastin e dytë kryerësi është në dijeni të veprimit të kryerjes dhe të karakteristikave tjera të veprës penale, por në lidhje me rrethanat nuk ekziston kurrfarë bindje apo siguri se do të ndodhë apo një mundësi e lartë për të ndodhur. Është e diskutueshme, posaçërisht nga aspekti i aplikimit praktik të ligjit, kur konsiderohet se kryerësi "pranon" ndodhjen e pasojës, pasi që pranimi është gjithashtu një qëndrim vullnetar ndaj pasojës, dhe problemi i vetëm është se si të përcaktohen përbërësit e tij.

Trupi gjykues konsideron se norma e supozimit të pafajësisë kuptohet në bazë të jurisprudencës së përcaktuar nga gjykatat ndërkombëtare penale, në këtë mënyrë që *"vetëm ato çështje të cilat janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm kundër një të akuzuari mund të jenë subjekt i dënimit të një të akuzuari apo të merren parasysh në rëndimin e atij dënimi"* (Co Nr. IT-96-21-A Gjykata Ndërkombëtare për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit të Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish Jugosllavisë), ndërsa *"rrethanat lehtësuese duhet të vërtetohen vetëm në peshimin e probabilitetit dhe jo përtej dyshimit të arsyeshëm"* (IT-95-9/2-S par.40).

Pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive të administruara gjatë gjyqimit, nga pikëpamja e komenteve të sipërpërmendura, trupi gjykues ka ardhur te përfundimi i vetëm logjik se Prokuroria nuk ka vërtetuar se i pandehuri është fajtor për vrasje, siç përshkruhet në pikën e parë. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues ka bazuar të gjeturat e tyre në provat që kanë kontribuar për supozimin për sa i përket qëllimit të të pandehurit dhe të bashkë-kryerësve tjerë, kur ata kanë hyrë në shtëpi dhe kanë filluar të maltretojnë Momčilo Milenkovićin.

Duke pasur parasysh të gjitha argumentet ligjore të përmendura më parë në aktgjykim dhe pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave të mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues

ka ardhur në përfundim se i pandehuri është fajtor përtej çdo dyshimit për kryerjen e krimit, ekspozim ndaj rrezikut si në pikën 3.

Përveç kësaj duhet të nënvizohet se sipas nenit 337 të Ligjit mbi Procedurën Penale, në rast të ndryshimit të aktakuzës, meqenëse prokurori ka gjetur se dëshmitë e paraqitura kishin treguar një ndryshim në statusin e fakteve nga ato që ishin të pranishme në aktakuzë, është paraqitur nevoja që aktakuza të dorëzohet në formë të shkruar. Pasiqë prokurori duke paraqitur aktakuzën me shkrim bëri më shumë se që pritej, mbrojtja nuk mund të pretendojë se kishte shkelje procedurale të ligjit. Një kopje e aktakuzës i është dorëzuar të akuzuarit dhe avokatëve mbrojtës të tij, por nuk është lejuar kurrfarë kundërshtimi i aktakuzës (neni 337, par.3). Përveç kësaj, trupi gjykues i ka lejuar të pandehurit që të bëjë një deklaratë në lidhje me pikën e ndryshuar, por ai deklarohet jo fajtor dhe refuzon të bëjë ndonjë deklaratë për sa i përket kësaj pike.

Për sa i përket pikës së dytë, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se në këtë drejtim, prokuroria nuk ka paraqitur asnjë dëshmi bindëse.

Sipas aktakuzës i pandehuri akuzohet për privimin e lirisë së lëvizjes së Svetomir Milenkovićit në një mënyrë joligjore dhe mizore që ka zgjatur për më shumë se 30 ditë, viktima është dërguar në një vend të panjohur ku ai është mbyllur dhe është duke u mbajtur akoma (pika 2 e aktakuzës).

Klasifikimi i veprës penale të privimit të paligjshëm të lirisë parashihet në nenin 63 paragrafin 4 lexuar me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë.

Duhet të theksohet se në bazë të dëshmive të mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor, një çështje është e qartë se Svetomir Milenković u zhduk menjëherë pas këtij sulmi kriminal, por nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri dhe personat tjerë të paidentifikuar të jenë përgjegjës për zhdukjen e tij . Deklarata bindëse e Jorgovanka Milenkovićit, e cila deklaroi:” *Pas asaj unë vrapova te një shtëpi e vjetër për të parë nëse vëllai im ishte atje. Unë nuk e gjeta atë. Më pas dëgjova dikë duke ndezur veturën dhe nuk jam e sigurt por mendoj se ishin ata. U ktheva në shtëpi duke e thirrur vëllain tim. E pashë se e kishin marrë televizorin por nuk e gjeta vëllain tim”.*

Dëshmitarja nuk ka thënë se ka parë personat që kishin hyrë me forcë të merrnin vëllain e saj, megjithëse ajo kishte rrethana të përkryera të vërente se ishte vjedhur televizori. Nga konkluzioni ne mund të vijmë në përfundim se pasi që ajo ka mundur të vërejë faktin se ishte vjedhur televizori, ajo gjithashtu do të mund të vërente faktin se Svetomir Milenković ishte kidnapuar. As deklarata e Valentina Aksentijevićit nuk ka mbështetur rrjedhën e ngjarjeve në favor të prokurorisë. Kjo dëshmitare i ka ofruar trupit gjykues shpjegime të dorës së parë:” *Dua të ju tregoj gjithashtu për dajën tim, i cili ishte në shtëpi kur djemtë erdhën në shtëpi për herë të parë, por ai ishte fshehur kur ata erdhën për herë të dytë, kështu që ata nuk e kanë parë atë. Ne nuk e dimë nëse ai kishte ikur apo nëse ata e kishin kidnapuar”.* Kjo dëshmitare tha këtë lidhur me incidentin, por ajo nuk dinte për fatin e dajës së saj të zhdukur.

Deklarata e Budimir Milenkovićit, forcon bindjen se Svetomir Milenković, përtej çdo dyshimi, është person i zhdukur. Ky fakt gjithashtu konfirmohet nga një letër nga Zyra për

Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (EULEX Kosovë) Alan Robinson, më datën 7 shtator 2009.

Asnjëra nga këto dëshmi të shqyrtuara veçmas dhe së bashku, nuk drejton tek konkluzioni i vetëm i mundur se Svetomir Milenković ishte privuar nga e drejta e tij, veçanërisht në mënyrë mizore. Sipas mendimit të trupit gjykues termi, mënyrë mizore, duhet të konsiderohet si shkaktrim i lëndimit trupor apo mendor, që tejkalon pasojat e zakonshme të privimit nga liria. Siç janë llojet e ndryshme të torturës, mungesa e ujit dhe ushqimit, poshtërimi dhe të ngjashme. Të gjitha dëshmitë e përmendura më parë duhet të konsiderohen në aspektin e provave rrethore. Prova rrethore është një dëshmi në një rast, e cila mund të përdoret për të nxjerrur një konkluzion në lidhje me një seri ngjarjesh. Dihet gjithashtu se e kundërta e dëshmisë jo e drejtpërdrejtë është dëshmia e drejtpërdrejtë. Provat rrethore zakonisht grumbullohen në një përmbledhje, kështu që secila pjesë vërtetohet me pjesët tjera (pjesët tani bëhen dëshmi të vërtetuara). Ato së bashku mbështesin më mirë konkluzionin se pohimi është i vërtetë. Provat rrethore duhet të mbliidhen dhe vërtetohen me kujdes kështu që provat na japin një pikturë të plotë dhe të qartë. Nëse prokuroria dështon të vërtetojë rastin, i pandehuri duhet të lirohet. Në ndërkohë dëshmia e lartpërmendur lejon krijimin e një skenari tjetër të mundshëm, që do të thotë se Svetomir Milenković ishte kidnapuar dhe pastaj vrazë dhe trupi i tij nuk është gjetur deri më sot.

#### IV. Llogaritja e dënimit:

Duke vendosur mbi dënimin, trupi gjykues ishte kufizuar nga dispozita e nenit 2 paragrafit 2 të KPK-së, që obligon të aplikohet ligji më shumë në favor të kryerësit të veprës në rast të ndërrimit të ligjit në fuqi në një rast të caktuar.

Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 përcakton ligjin e zbatueshëm në Kosovë si "ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989". Për qëllim të këtij rasti Kodi Penal i Kosovës (28 korrik 1977) dhe Kodi Penal i Serbisë (30 qershor 1977) janë ligjet e zbatueshme së bashku me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Rregullorja e sipër përmendur konsiderohet të ketë hyrë në fuqi që nga 10 qershor 1999, që do të thotë para se që është kryer vepra penale (neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24).

Sipas nenit 42 paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (28 korrik 1977), mund të shqiptohet dënimi prej një deri në tetë vjet burgim për kryerjen e këtij krimi. Sipas nenit 156 paragrafit 4 të KPK-së lexuar me nenin 38, që është i barasvlershëm me rregulloren e mëparshme, i pandehuri mund të dënohet me burgim prej së paku pesë e deri në njëzet vjet. Nga konkluzioni mund të transmetohet se ligji në fuqi në kohën kur është kryer krimi ishte më i butë se Kodi Penal i Kosovës. Trupi gjykues ka marrë parasysh mungesën e limitimit statutor të ndjekjes penale, pasi që krimi i përshkruar në pikën 2 ishte kryer më 2 gusht 1999.

Neni 95 (1) pika 3 përcakton se ndjekja penale është ndaluar pas kalimit të kohës: 10 vite nga kryerja e veprës penale për të cilën ligji parasheh burgim për një periudhë që tejkalon pesë vite. Më tej lexohet (neni 96) se periudha e kufizimit të ndjekjes penale fillon me ditën në të cilën është kryer vepra penale. Afati i periudhës së kufizimit ndërpritet me çdo veprim procedural që lidhet me ndjekjen penale të kryerësit të veprës për shkak të veprës penale të

kryer. Një periudhë e re kufizimi fillon me çdo ndërprerje. Duhet të ketë një pengesë absolute ndaj ndjekjes kur ka kaluar kohë dy herë më shumë, siç kërkohet në pajtim me ligjin, për pengimin e ndjekjes. Veprimet procedurale duke shkaktuar ndërprerje të kufizimit ligjor mund të ndërmerren nga gjykata me qëllim të ndjekjes penale të kryerësit për kryerjen e veprës penale. Veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata janë veprime hetimore, siç janë lëshimi i fletë arrestit për të akuzuarin kundër të cilit janë filluar procedurat penale, kur i akuzuari gjendet në liri (Ljubisa Lazarevic- Komentimi i Kodit Penal të ish Jugosllavisë 1995, edicioni i 5-të). Bazuar në dokumentacionin e marrë gjatë rrjedhës së këtij rasti është e qartë se Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 7 nëntor 2002, ka lëshuar një urdhër arrest kundër të pandehurit. Prandaj, trupi gjykues është i mendimit se procedura penale kundër të pandehurit për kryerje të veprës penale (pika 2) nuk mund të ndalohej, pasi që kufizimi ligjor do të kalonte më 7 nëntor 2012.

Sipas nenit 41 të KPRSJ kur gjykata merr një aktgjykim duhet të ketë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat që janë relevante me zbutjen apo rëndimin e dënimit. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kundërvajtësit.

1. Si rrethana lehtësuese:

- I akuzuari ka qenë i ri kur ka kryer këtë krim,
- Krimi është kryer shumë kohë më parë,
- Ai është dashur të kalojë një kohë të gjatë në paraburgim,

2. Si rrethana rënduese:

- Intensitet i lartë rreziku ndaj vlerave të mbrojtura domethënë: jetës dhe trupit të një qenie tjetër njerëzore, si pasojë e veprës penale, Momčilo Milenković, humbi jetën e tij,
- Sulmi, vonë pasdite në shtëpi, që konsiderohet si vend i sigurt, veç kësaj ky sulm i ka shkaktuar Valentinës një stres të gjatë traumatik dhe i ka shkaktuar familjes që të shpërngulet në një vend më të sigurt.

Duke i marrë parasysh me kujdes të gjitha këto rrethana, trupi gjykues ka gjetur se burgimi prej gjashtë (6) viteve do të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për t'i shërbyer të gjitha qëllimeve të dënimit të përmendur në nenin 41 të KPRSJ.

Duke marrë parasysh rrethanat e sipër përmendura, trupi gjykues ishte i mendimit se kryerësi i veprës nuk ka merituar të trajtohej më butë. Veprimet e të pandehurit siç janë paraqitur duhet të dënohen ashpër. Në këtë rast vetëm dënimi i burgimit pa pezullim do të garantonte se do të arrihej qëllimi i dënimit kundër kundërvajtësit, dhe veçanërisht ai nuk do t'i rikthehet krimit. Ky dënim do ta bind të pandehurin se ligji duhet të respektohet.

Sipas nenit 351 paragrafit 6 të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP) dhe nenit 50 paragrafit 1 të Kodit Penal të RSFJ (KPJ), kohën të cilën Besim Berisha aka Burim Dibrani ka kaluar në paraburgim nga 3 gusht 1999 deri më 20 mars 2000, dhe nga 27 gusht 2008 (kur është deportuar nga Franca) derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, duhet të përfshihet në lartësinë e dënimit.

## **V. Shpenzimet e procedurës penale.**

Sipas nenit 98 paragrafit 1 të LPP, ai duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej dyqind (200) Eurove për veprën penale të ekspozimit ndaj rrezikut.

**Procesmbajtëse**

**Kryetari i trupit gjykues**

**Nexhmije Mezini**

**Arkadiusz Sedek**

### **MJETI JURIDIK:**

Sipas nenit 359 të LPP, ankesa mund të paraqitet kundër këtij aktgjykimi përmes kësaj gjykate brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi i aktgjykimit me shkrim. Ankesa e ndalon ekzekutimin.